



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

**RREGULLORE
E
PLANIT TË SISTEMIT RRUGOR
NJËSIA STRUKTURE**

1/162

HARTOI:

Ark. Alba Canaj

Ing. Ariola Muhametaj

Urb. Marvis Avllazagaj


Ing. Roland Dyrma

z. Denis Hasa

Ing. Bruno Korumi

Ing. Gentiana Kerri

1. PROPOZIMET E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR NË NJËSINË STRUKTUREORE ME KOD NR. 1/162



Fragment nga harta e njësive strukturore e PPV-së Elbasan

Njësia strukturore 1/162

Njësia Strukturore me kod. 1/162 ndodhet në periferinë e qytetit të Elbasanit në anën perëndimore të tij dhe kufizohet:

Në veri me Njësinë Strukturore me kod. 1/158.

Në lindje me Njësinë Strukturore me kod. 1/165 dhe rrugët “Kasem Kodra” e “Hasan Çifte”.

Në jug me rrugën “Qamil Lopari ».

Në perëndim me rrugën « Ymer Peni”.

Plani i Përgjithshëm Vendor



7/25/2024, 12:30:16 PM


Njësitë Strukturore

- A.Banim
- BA.Bujqesi + Banim
- S.Sherbime

PDV RKPT

- Faza 1: Ne proces
- PPV Rrjeti Rrugor i Propozuar
- D. Rruge Urbane Kryesore
- E. Rruge Urbane Dytësore

Mapas, Microsoft



1.1 KATEGORITË E PËRDORIMIT TË TOKËS TË PROPOZUAR NË NJËSINË STRUKTURE ME KOD NR. 1/162

Njësia strukturore në studim i përket sistemit UB (urban), referuar Rregullores së PPV-së miratuar të Bashkisë Elbasan, pasaportës së Njesisë Strukturore 1/162.

Kategoritë bazë të përdorimit të tokës janë:

- 01.Banim në masën 75 %;
- 04. Shërbime në masën 25 %

Pra objektet e banimit të cilat do të kenë lartësinë maksimale 4 katë ose 14 m, do të zënë rreth 75 % të sipërfaqes së përgjithëshme të planifikuar për ndërtim në këtë njësi duke respektuar treguesit urbanë të PPV-së.

Objektet e Shërbimit që do të ndërtohen do të kenë lartësinë maksimale 4 katë ose 14 m, do të zënë rreth 25 % të sipërfaqes së përgjithëshme të planifikuar për ndërtim në këtë njësi, duke respektuar treguesit e propozuar urbanë të njësisë.

Tipologjia e ndërtimit e propozuar për njësinë strukturore 1/162 është **ViLa & Sh**

Në kategorinë banim përfshihen ndërtesa banimi njëfamiljare, të tipologjisë hapësinore me kod :

ViLa : Vila me densitet të lartë. Zonë me dominim tipologjie ndërtesa tip vile njëfamiljare, edhe të bashkëngjitura, në më shumë se, 80% të ndërtesave. **Sh : Zonë me tipologji ndërtesash shërbimi**, ku ndërtesat janë të tipologjisë specifike për këto përdorime. Funksionet që përfshihen në këtë kategori janë të ndryshme e përfshijnë objekte tregtare, objekte rekreative, restorante e bare etj, sipas përcaktimeve ligjore.

Kjo njësi ka hapësira publike të limituara, të cilat kanë nevojë për investime të vazhdueshme sipas përcaktimeve dhe propozimeve të hartimit të Planit të Sistemit Rrugor.

Kjo zonë përballet me mungesë organizimi të strukturave ekzistuese dhe rrugëve në brendësi të saj.

Në këtë njësi do të bëhet ndërhyrje në rikualifikimin dhe rrizhvillimin e hapësirave publike e private të degraduara dhe zhvillimin e atyre të reja.

Duke vendosur rregulla të qarta për zhvillimet e reja dhe ato ekzistuese, Njësia 1/162 në studim ka nevojë për një program të plotë rigjenerues të të gjithë hapësirave publike të brendshme në pjesën e ndërtuar të saj, përmirësimin e rrjetit rrugor sipas këtij plani, sipërfaqeve të parkimit si publik dhe privat dhe të infrastrukturave të tjera të nevojshme.


Ndërhyrja në territor do të bëhet duke marrë në konsideratë përmirësimin dhe shtimin e infrastrukturave publike për njësinë 1/162.

Ndërhyrja do të kryhet duke marrë parasysh standartet dhe treguesit që përcaktohen në VKM nr. 686 datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" në VKM nr.1096 datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve, procedurave përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike" dhe me PPV të miratuar me vendim të KKT Nr.1 datë 29.12.2016, ndryshuar me vendim të KKT-se Nr 2 date 24.11.2021 dhe Vendim të KKT Nr.03, date 25.04.2023 , ku ndër të tjera parashikohet që për çdo banor të ketë minimalisht 2.5 m²/banor gjelbërim.

Nga ana jonë është hartuar Harta e Sistemit të ri rrugor, në të cilën vetë Njësia strukturore me kod 1/162, është ndarë në 6 nën-njësi strukturore A1, A2, A3, A4, A5, A6, sipas planit të ri rrugor të propozuar. Rrugët ekzistuese janë përshtatur me treguesit teknikë të vendosur në PPV-në e miratuar të qytetit Elbasan dhe ndryshimet e miratuara të tij. Ato duhet të pajisen me trotuarët publikë, elementët e nevojshëm të mobilimit urban, sinjalistikën, infrastrukturën publike dhe sipërfaqet e planifikuara të parkimit sipas PPV. Rrugët ekzistuese në brendësi të zonës në studim janë lidhur midis tyre dhe me rrugët kryesore, duke respektuar propozimet e rrugëve dhe prerjeve tërthore të rrugëve sipas PPV-së.

Harta e sistemit të ri rrugor të propozuar dhe nën-njësitë

SISTEMI I RI RRUGOR



1.2 MENYRAT E NDËRRHYRJES NË NËN-NJËSITË E NJËSISË STRUKTURE 1/162

Referuar PPV-së Elbasan mënyra e propozuar e ndërhyrjes në këtë Njësi strukturore është:

Konsolidim (Consolidation, që nënkupton edhe Kompaktësim) : Përveç sa parashikon rregullorja e planifikimit, e miratuar me VKM, në këtë rregullore ky term thellohet më tej edhe në: **Është një proces zhvillimi dhe rizhvillimi në të cilin konsolidohet karakteri dhe tipologjia ekzistuese e zonës** (në rastin konkret urbane) dhe për këtë kryhen punime ndërtimi, rindërtimi, ristrukturimi, rigjenerimi të pjesshëm, mbushjeje urbane, konservimi dhe pastrimi. Këto punime kombinohen në pesha të ndryshme.

Më poshtë citojmë dhe konceptin e një procesi zhvillimi dhe rizhvillimi sipas PPV-së, i ndodhur dhe i detajuar në paragrafin e sipërcituar (Konsolidim):

Zhvillim (Development): Është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndërtimeve të reja, të shoqëruara edhe me infrastrukturën përkatëse. Në raste të veçanta, zhvillimi mund të përfshijë vetëm

programin e pajisjes së zonës me infrastruktura, duke tërhequr kështu zhvilluesit për ndërtime private. Zhvillimi ndikon në ndryshimin e çmimit të tokës dhe, përgjithësisht, e ngre atë.

- **Rizhvillim (Redevelopment):** Përveç sa parashikon rregullorja e planifikimit, e miratuar me VKM, në këtë rregullore ky term thellohet më tej edhe në: Zhvillim që kryhet përsëri në një zonë e cila është zhvilluar më parë. Është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndryshimit të ndërtimeve ekzistuese, si të formës e strukturës, ashtu edhe funksioneve dhe/ose treguesve të zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp).

Në këtë mënyrë njësia 1/162 klasifikohet në një bllok të vetëm me ndërhyrje konsolidimi.

Ndërhyrja për konsolidim ka për qëllim rritjen e kapacitetit mbajtës të banorëve në nën – njësi dhe permirësimin e infrastrukturës së brendshme, nëpërmjet ndërhyrjeve të kompaktësimit, zhvillimit dhe rizhvillimit duke respektuar treguesit e zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp) të përcaktuar në PPV. Pra krijohen disa lote të cilat konsiderohen nën – njësi dhe kanë të parashikuara sipërfaqen totale të ndërtimit të ri, kontributin për hapësira publike, për rrugë dhe për parkim. Distancat e objekteve të reja nga rrugët e propozuara (vijat e ndërtimit) janë propozuar 3m nga gjurmët e rrugëve të zgjeruara, ose të hapura, sipas PPV-së dhe këtij plani dhe janë përcaktuar referuar vendim të KKT Nr.1 datë 29.12.2016, ndryshuar me vendim të KKT-se Nr 2 date 24.11.2021 dhe Vendim të KKT Nr.03, date 25.04.2023 dhe aneksit të tabelave për sejcilën rrugë të propozuar në këtë njësi.

TABELA E TREGUESVE PËR ZHVILLIM

TREGUESIT PER NJESINE STRUKTURE 1/162	EKZISTUES			Propozimi PPV	DIFERENCA lidhur me gjendjen ekzistuese	PROPOZIMI I PLANIT TE SISTEMIT RRUGOR		DIFERENCA lidhur me gjendjen ekzistuese
SIPERFAQJA E NJESISE (m ²)	97815.6			97815.6	0	97815.6		0
INTENSITETI I NDERTIMIT BRUTO	0.15			0.5	0.35	0		0
KOEFICIENTET E SHFRYTEZIMIT TE TERRITORIT PER RRUGE KSHR (m ² dhe %)	2934.47	3%		min. 8%	7,825.2	10,759.7	11%	8.0%
KOEFICIENTET E SHFRYTEZIMIT TE TERRITORIT PER HAPESIRA PUBLIKE KSHR (m ² dhe %)	0	0%		min. 8%	7,825.2	7,825.2	8.00%	8.00%
Treguesit për zhvillim sipas nën njësisë								
NENNJESI PER KONSOLIDIM (punime ndërtimi, rindërtimi, rristrukturimi, rigjenerimi të pjesshëm, mbushjeje urbane, konservimi dhe pastrimi, sipas PPV)	NENNJESI	SIPERFAQE BRUTO	INTENSITETI I NDERTIMIT	SIPERFAQE NDERTIMI TOTAL	KONTRIBUTI PER HAPESIRA PUBLIKE 8%	KONTRIBUTI PER RRUGE 11%	Koeficienti i shfrytëzimit territorit KSHT	Lartësia e propozuar (Kate)
	A1	22,565.85	0.50	11282.93	1805.27	2,482	35%	4
	A2	24,488.23	0.50	12244.12	1959.06	2,694	35%	4
	A3	8,376.24	0.50	4188.12	670.10	921	35%	4
	A4	7,277.24	0.50	3638.62	582.18	800	35%	4
	A5	17,785.18	0.50	8892.59	1422.81	1,956	35%	4
	A6	17,322.85	0.50	8661.43	1385.83	1,906	35%	4
TOTALI (m ²)		97,815.6		48,907.8	7,825.2	10,759.7		7,200
TOTALI	SIPERFAQE E NJESISE (m ²)	SIP. TOT. E NDERTIMIT PER NJESINE STRUKT. (m ²)	SIPERFAQE TRUALLI PER KONSOLIDIM (punime ndërtimi, rindërtimi, rristrukturimi, rigjenerimi të pjesshëm, mbushjeje urbane, konservimi dhe pastrimi, sipas PPV) (m ²) (35%)		KONTRIBUTI I PROPOZUAR PER HAPESIRA PUBLIKE, TE GJELBRA, REKREATIVE DHE RRUGE (m ²)		KONTRIBUTI I PROPOZUAR PER PARKIM (m ²)	
	97815.6	48,907.8	34235.46		18585		7,200	

2. PLANI I PROPOZUAR RRUGOR DHE PËRDORIMIT TË TOKËS

Në përdormin e propozuar të tokës përmirësohet, zgjerohet dhe hapet infrastruktura rrugore. Në ndërtimet e reja të propozuara parashikohet të paktën një parkim për cdo njësi apartament dhe një parkim për 100 m² hapësirë shërbime apo aktivitete të tjera ndihmëse.

Fasadat e objekteve të ndërtuara para dhe pas 1990-ës nuk janë në gjendje të mirë fizike në shumicën e tyre, ndaj ndërhyrja në to është e nevojshme. Kjo ndërhyrje do të bëhet duke iu përshtatur funksionit dhe karakterit të tyre. Kështu psh. katet e para të cilat ofrojnë shërbime tregtare do të trajtohen ndryshe nga ato të tjerat funksioni i të cilave është banim. Propozohet shtim kati në objektet ekzistuese të ndërtuara nëse strukturat mbajtëse e lejojnë por jo më shumë se 4 kate ose 14 m dhe duke respektuar distancat minimale të lejuara nga kufiri i pronës, nga objektet fqinje, nga rrugët si dhe treguesit urbanë të lejuar sipas PPV-së.

Sugjerohet dhe nxitet realizimi i parkimeve nëntokësore, publike dhe private, të cilët ndihmojnë në ruajtjen e sipërfaqeve të lira, dhe plotësimin e nevojave të zonës për parkim, duke respektuar treguesit urbanë të mirëpërcaktuar, të cilët mundësojnë plotësimin e kriterëve të zonës dhe sipërfaqet e nevojshme minimale të nevojshme për çdo funksion të propozuar.

Rrjeti rrugor i propozuar konsiston në ritrajtimin e profileve të dy rrugëve perimetrale ekzistuese, dhe rikonceptimin, lidhjen, zgjerimin dhe hapjen e rrugëve të brendshme, duke patur parasysh gjerësinë e tyre dhe të trotuarëve, sipas rregullores së PPV-së miratuar dhe ndryshuar.

Duhet patur parasysh shtresat rrugore që të sigurojnë qëndrueshmëri duke parashikuar kapacitetet mbajtëse të perspektivës, të propozuara nga PPV dhe kalimin e makinerive me tonazh mesatar dhe të lartë, pasi zona është e parashikuar dhe për shërbime.

Në zgjerimin dhe rristurimin e rrugëve parashikohen edhe parkimet e automjeteve.

Hapësirat e parkimeve do të integrohen në zonë duke mos shqetësuar lëvizjet e këmbësorëve ose zhvillimin e aktiviteteve të tjera. Parkimet do të jenë si publike dhe private, pra në brendësi të parcelave. Në këtë mënyrë në zonën përkatëse do të krijohen kushte më të mira jetese, duke ulur edhe nivelin e ndotjes, për të qënë në shërbim të banorëve dhe aktiviteteve përkatëse të planifikuara.

Rikualifikimi, rikonstrukcioni, zgjerimi dhe krijimi i rrugëve hyrëse dhe dalëse në njësi dhe nën njësitë e saj, do lehtësojë zhvillimin e funksioneve dhe aktiviteteve përkatëse në shërbim të komunitetit.

Problematika e parkimit duhet të zgjidhet duke i integruar këto vende në mënyrë të tillë, që të mos shqetësojnë trajektoret për hyrjet e zjarrfikseve dhe veprimtarinë e përdoruesve të këtyre hapësirave.

Rrjeti i ri rrugor i propozuar ka si qëllim sistemin e kësaj nënjësie me gjithë elementët e infrastruktures si :

- Rrugët;
- Kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza të dëmtuara, të pamjaftueshme ose inegzistente;
- Rrjetin e ujesjellës, furnizimit me energji elektrike, internetit, telefonisë, hidranteve, etj;
- Ndriçimin publik.
- Gjelbërimin publik;

Hapja e rrugëve të reja në njësinë strukturore do të vijë si rrjedhojë e zhvillimit të nën njësive strukturore rast pas rasti. Kur të jetë arritur dakordësia e zhvillimit të nën-njësisë, planifikuesit duhet të kenë parasysh që të projektojnë, sipas Planit të Sistemit Rrugor të Miratuar.


Gjithsesi rrugët kryesore janë planifikuar mbi gjurmë rrugësh ekzistuese, në mënyrë që

infrastruktura rrugore të realizohet sa më lehtë. Edhe rrugët e brendshme janë realizuar sipas gjurmëve ekzistuese në pjesën më të madhe të tyre, përveç rrugëve të reja që kanë patur për qëllim bashkimin e akseve ekzistuese, zgjerimin e tyre dhe lidhjen e tyre me akset e rëndësishëm rrugore dhe njësitë strukturore fqinje. (Në çdo rast kur të investohen hapjet, apo zgjerimet e rrugëve publike do të respektohen aktet ligjore të shpronësimit publik.)


2.1. TIPOLOGJITË E RRUGËVE TË PROPOZUARA NË PLANIN E SISTEMIT RRUGOR TË NJËSISË ME KOD. 1/162

Harta e sistemit të ri rrugor të propozuar


SISTEMI I RI RRUGOR




Prerja tërthore e rrugës BR-ZZZ-ZZZ' në perëndim të Njesisë




Prerja tërthore e rrugës KOL-BB-BB' në jug e jug-lindje të Njesisë




Prerja tërthore e rrugës Br-R-R'



Prerja tërthore e rrugës Br-AR-AR'



Prerja tërthore e rrugës Br-TT-TT'



3. NENET E PPV-së APLIKUAR NË STUDIMIN E NJËSISË STRUKTURE 1/162.

3.1 Neni 8 i PPV - Vija e ndërtimit përcaktohet nëpërmjet rregullave të distancave të objekteve nga kufiri i pronës dhe nga rruga në njësitë strukturore dhe zonat me prioritet zhvillimi. Për sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore, vija e ndërtimit respekton:

- distancat e ndërtimeve nga kufiri i pronës sipas rregullores së zhvillimit të territorit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
- distancat e ndërtimeve nga rruga sipas rregullores së zhvillimit të territorit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
- vijën e ndërtimit të krijuar në territor, ose atë të përcaktuar nga PDV-ja sipas kësaj rregulloreje.

4. Rregullat bazë për infrastrukturën e lëvizjes.

4.1 Kategoritë e sistemit rrugor sipas Kodit Rrugor.

4.1.1 Kategoritë e sistemit rrugor sipas Kodit Rrugor (ligji nr.8378, date 22.7.1998, i ndryshuar)

5. Dispozita përfundimtare


5.1 Çdo shkelje e rregullave të përcaktuara në këtë rregullore përbën kundërvajtje dhe dënohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

5.2 Bashkia zgjidh çdo çështje të menaxhimit të zhvillimit të territorit për zbatimin e Planit që nuk gjen zgjidhje në këtë rregullore përmes zbatimit të legjislacionit në fuqi, me miratim të institucioneve përkatëse sipas rasteve.

5.3. Bashkia zbaton standardet e parashikuara në këtë rregullore për sa kohë ato nuk përcaktohen në legjislacionin e posaçëm në fuqi dhe nëse standardet e kësaj rregulloreje janë më shtrënguese dhe të përmirësuara se sa ato në legjislacionin e posaçëm. Bashkia i rishikon këto standarde nëse ndryshon legjislacioni i posaçëm.

5.4 Distancat nga kufiri i prones, rrugës apo objekteve përcaktohen sipas VKM 408 të ndryshuar.

5.5 Në sistemin rrugor të propozuar janë patur në konsideratë rekomandimet e PPV-së së miratuar me vendim të KKT Nr.1 datë 29.12.2016, ndryshuar me vendim të KKT-se Nr 2 date 24.11.2021 dhe Vendim të KKT Nr.03, date 25.04.2023, si më poshtë:





Rregull sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësi e prapësuar	Kodi (funksion)	Kodi (rrugë)	Kodi (gjerësi)	Ndërhyrja	Ndërkohë	Kodi emergjence	Kodi zona	Transporti publik	Gjallërimi	Kodi bishkërie	Trenuar	Vija e ndërimit
Aksioner	LOKALE	6	AL	AL-F	F	Ristrukturim	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)
Aksioner	LOKALE	6	AL	AL-F	F	Zgjerim	PO	JO	1	JO	PO	PO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-AD	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	10 (5 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-AD	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	10 (5 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-AP	F	Ekzistues dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	LOKALE	8	Br	Br-AL	F	Ekzistues dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	LOKALE	8	Br	Br-AN	F	Maks (Zgjerim + Ndërim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-AR	F	Maks (Zgjerim + Ndërim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-B	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	LOKALE	8	Br	Br-C	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga një anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-D	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	10 (3 m në zonë të banuar)

49

Rregull sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësi e prapësuar	Kodi (funksion)	Kodi (rrugë)	Kodi (gjerësi)	Ndërhyrja	Ndërkohë	Kodi emergjence	Kodi zona	Transporti publik	Gjallërimi	Kodi bishkërie	Trenuar	Vija e ndërimit
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	8	Br	Br-OD	E	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	12	Br	Br-P	E	Ristrukturim	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	8	Br	Br-PV	E	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	8	Br	Br-R	E	Maks (Zgjerim + Ndërim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	8	Br	Br-RR	E	Ekzistues dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	8	Br	Br-S	E	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	8	Br	Br-T	E	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	8	Br	Br-U	E	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	8	Br	Br-V	E	Maks (Zgjerim + Ndërim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	12	Br	Br-VV	E	Ekzistues dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)
Rregull të brendshme	URBANE DYTËSORE	12	Br	Br-X	E	Ekzistues dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anë	10 (3 m në zonë të banuar)

63

Grupë dhe funksionet	Kodi i grupit	Cjfrat e propozuar	Kodi (funksion)	Kodi (përje)	Kodi (grima)	Ndërhyrja	Ndërtim	Kodi emergjencë	Kodi msh.	Transport publik	Cjfrat e grupit	Kodi bërthamë	Tretuari	Vija e ndërtimit
Grupë të brendshme	LOKALE	5	It	It-TT	F	Eksistues dhe mirëmbajtje	It	It	1	It	It	It	It, nga dy anë	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë të brendshme	LOKALE	6	It	It-TTT	F	Eksistues dhe mirëmbajtje	It	It	2	It	It	It	It	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë të brendshme	LOKALE	6	It	It-UU	F	Eksistues dhe mirëmbajtje	It	It	1	It	It	It	It, nga dy anë	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë të brendshme	LOKALE	6	It	It-UUU	F	Zgjerim	It	It	2	It	It	It	It	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë të brendshme	LOKALE	6	It	It-VVV	F	Rindërtim	It	It	2	It	It	It	It	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë bujqësore	LOKALE	6	Ba	Ba-B	F	Zgjerim	It	It	2	It	It	It	It	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë bujqësore	LOKALE	4	Ba	Ba-C	F	Rindërtim	It	It	1	It	It	It	It	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë bujqësore	LOKALE	6	Ba	Ba-D	F	Nënim	It	It	2	It	It	It	It	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë bujqësore	LOKALE	6	Ba	Ba-E	F	Zgjerim	It	It	2	It	It	It	It	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë bujqësore	LOKALE	6	Ba	Ba-F	F	Rindërtim	It	It	2	It	It	It	It	It (5 m në zonë të banuar)
Grupë bujqësore	LOKALE	6	Ba	Ba-G	F	Rindërtim	It	It	1	It	It	It	It	It (5 m në zonë të banuar)

